

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

UNMIK/REG/2006/6
16 shkurt 2006

RREGULLORE NR. 2006/6

MBI INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën nr. 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/24 të datës 12 dhjetor mbi ligjin në fuqi në Kosovë,

Duke marrë parasysh kapitullin 10 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001) dhe nenin 20 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/38 të datës 30 qershor 2000 mbi themelimin e institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës,

Pas konsultimeve me Kuvendin e Kosovës dhe me Qeverinë,

Me qëllim të kalimit të përgjegjësive për veprimtarinë e vazhdueshme të institucionit të Avokatit të Popullit,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1

Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë

1.1 Institucioni i Avokatit të Popullit mbikëqyr, avancon dhe mbron të drejtat dhe liritë e banorëve të përhershëm të Kosovës dhe të personave fizikë e juridikë në territorin e Kosovës, për të siguruar që të gjithë personat e tillë të kenë mundësi të ushtrojnë në mënyrë efektive të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale, të mbrojtura me standardet

ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të përfshira në ligjin në fuqi në pajtim me nenin 1.3 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999 mbi Ligjin në fuqi në Kosovë dhe paragrafin 3.3 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr.2001/9 e datës 15 maj 2001), veçanërisht Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

1.2 Institucioni i Avokatit të Popullit siguron mekanizma të cilëve njerëzit mund t’iu qasen në kohën e duhur për shqyrtimin e veprimeve që përbëjnë keqpërdorim të pushtetit nga institucionet e Kosovës dhe ofron rekomandime për korrigjimin e tyre. Nëse nga keqpërdorimi i pushtetit pason dëm i rëndë i vazhdueshëm, Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të përshpejtuar i rishqorton veprimet që përbëjnë keqpërdorimin e pushtetit dhe ofron rekomandime për korrigjimin e tyre.

1.3 Termi “institucionet e Kosovës”, ashtu siç është përdorur në këtë Rregullore, përfshin çdo institucion të përkohshëm të vetëqeverisjes dhe çdo organ apo agjenci të tyre, çdo komunë dhe çdo organ apo agjenci të tyre dhe çdo organ të pavarur apo zyrë të përcaktuar në paragrafin 11.1 të Kornizës Kushtetuese (Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë) ose cilindo organ apo zyrë tjetër të pavarur të themeluar me ligj të paraparë në paragrafin 11.2 të Kornizës Kushtetuese.

1.4 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, pas konsultimit me Avokatin e Popullit, si masë të përkohshme mund të caktojë një (1) apo më shumë këshilltarë për të ndihmuar institucionin e Avokatit të Popullit në përmbushjen e mandatit të tij, për një periudhë fillestare prej një viti pas caktimit të Avokatit të Popullit.

1.5 Pas kësaj mund të caktohet një apo më shumë këshilltarë ndërkombëtarë nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për të ndihmuar institucionin e Avokatit të Popullit në përmbushjen e mandatit të tij, me kërkesën e Avokatit të Popullit.

Neni 2

Natyra e institucionit të Avokatit të Popullit

2.1 Institucioni i Avokatit të Popullit vepron në mënyrë të pavarur. Asnjë person apo subjekt nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e funksioneve të tij.

2.2 Shërbimet e ofruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë falas.

Neni 3

Kompetencat

3.1 Institucioni i Avokatit të Popullit ka kompetenca për të pranuar dhe hetuar ankesat nga çdo banor i përhershëm i Kosovës apo nga personi fizik a juridik në territorin e Kosovës lidhur me shkeljen e standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut të përfshira në ligjin dhe aktet në fuqi, duke përfshirë edhe mosndërmarrjen e veprimeve, që përbëjnë keqpërdorim të pushtetit nga institucionet e Kosovës.

3.2 Kompetencat e institucionit të Avokatit të Popullit shtrihen në mbarë territorin e Kosovës. Në ushtrimin e funksioneve të tij lidhur me rastet që paraqiten brenda territorit të Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit mund t'u ofrojë shërbimet e veta banorëve të përhershëm të Kosovës të cilët përkohësisht ndodhen jashtë territorit të Kosovës.

3.3 Institucioni i Avokatit të Popullit ka kompetenca për rastet që paraqiten pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje dhe për rastet që nga faktet kuptohet se janë paraqitur para kësaj date, kur këto fakte paraqesin vazhdimin e shkeljes së një apo më shumë standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut apo përbëjnë keqpërdorim të vazhdueshëm të pushtetit.

3.4 Institucioni i Avokatit të Popullit mund të lidhë marrëveshje bilaterale me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurat për trajtimin e rasteve ku përfshihet UNMIK-u.

Neni 4

Funksionet dhe kompetencat

4.1 Institucioni i Avokatit të Popullit ka këto përgjegjësi:

(a) Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin e Kosovës dhe çdo institucion tjetër kompetent të Kosovës mbi çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;

(b) T'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta;

(c) Të shqyrtojë dhe të raportojë për legjislacionin e Kuvendit dhe për dispozitat administrative në fuqi të institucioneve të Kosovës, për projektlegjislacionin dhe propozimet e Kuvendit dhe të bëjë rekomandime të tilla, të cilat sipas mendimit të tij janë të duhura për të siguruar që këto dispozita të jenë nëpajtueshmëri me standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.;

(d) Të rekomandojë miratimin e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve të Kuvendit që janë në fuqi dhe miratimin apo ndryshimin e masave administrative nga institucionet e Kosovës;

(e) Të hetojë dhe të raportojë për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të përpiqet të zgjidhë çdo rast të shkeljeve të tilla;

(f) Të përgatisë raporte të gjendjes në Kosovë lidhur me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe për çështjet më specifike;

(g) Të tërheqë vëmendjen për rastet në cilëndo pjesë të Kosovës ku institucionet e Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjnë propozime që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe, kur është e domosdoshme, të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e Qeverisë;

(h) Të mbështesë dhe të sigurojë harmonizimin e legjislacionit të Kuvendit me standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv;

(i) Duke vepruar në pajtueshmëri me Kornizën Kushtetuese, të bashkëpunojë me UNMIK-un, me Zyrën e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut dhe me çdo organ tjetër të Kombeve të Bashkuara, me Këshillin e Evropës dhe me institucionet tjera rajonale jashtë Kosovës, të cilat janë kompetente në fushën e mbrojtjes dhe të avancimit të të drejtave të njeriut dhe

(j) Të bëjë të njohur të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit, veçanërisht diskriminimin racor dhe etnik me ngritjen e vetëdijësimit publik, sidomos përmes informimit dhe edukimit dhe shfrytëzimit të mediave.

4.2 Institucioni i Avokatit të Popullit mund t'i ushtrojë kompetencat e veta mes tjerash përmes bashkërendimit, ndërmjetësimit dhe pajtimit.

4.3 Institucioni i Avokatit të Popullit mund t'i ofrojë këshilla dhe t'i bëjë rekomandime çdo personi fizik apo juridik lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve vendore me standardet e pranuar ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Kompetencat e institucionit të Avokatit të Popullit për të ofruar këshilla dhe për të bërë rekomandime të tilla nuk e cenojnë pushtetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas nenit 2 të Rregullores së ndryshuar të NMIK-ut nr. 1999/24 të datës 2 dhjetor 1999 mbi ligjin në fuqi në Kosovë për të dhënë sqarime lidhur me zbatimin e rregullores së tillë.

4.4 Institucioni i Avokatit të Popullit ka kompetenca për të këshillur dhe për të rekomanduar institucionet e Kosovës mbi programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut në Kosovë.

4.5 Institucioni i Avokatit të Popullit ka kompetenca për të bërë hetime, qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar sipas nenit 3.1 apo me iniciativën e vet.

4.6 Institucioni i Avokatit të Popullit i ndërmerr të gjitha hapat dhe veprimet e nevojshme për t'i shqyrtuar ankesat e parashtruara sipas nenit 3.1, duke përfshirë edhe intervenimin e drejtpërdrejtë tek autoritetet kompetente, nga të cilët do të kërkohet që të

përgjigjen brenda kohës së arsyeshme. Nëse vazhdon dëmi i rëndë si pasojë e çështjes së ankesës nga neni 3.1, nga autoritetet kompetente kërkohet që të përgjigjen me nguti.

4.7 Kur, Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë hetimeve konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik, Institucioni i Avokatit të Popullit mund të rekomandojë që autoriteti kompetent ta pezullojë ekzekutimin e vendimit në fjalë.

4.8 Institucioni i Avokatit të Popullit ka qasje në dosjet dhe dokumentet e çdo institucioni të Kosovës dhe mund t'i shqyrtojë ata lidhur me rastet që i ka në shqyrtim dhe, sipas kësaj Rregulloreje, mund të kërkojë nga çdo institucion i Kosovës dhe nga personeli i tyre që të bashkëpunojnë me institucionin e Avokatit të Popullit, duke siguruar informacione relevante, dokumente dhe dosje. Ndonjë institucion i Kosovës mund të refuzojë dhënien e dosjes(eve) ose dokument(eve)it institucionit të Avokatit të Popullit në rrethanat në të cilat, në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, refuzimi i dhënies së dokumentit Avokatit të Popullit shprehimisht është i lejuar, me kusht që arsyet t'i paraqiten institucionit të Avokatit të Popullit me shkrim. Institucioni i Avokatit të Popullit mund të nxjerrë konkludime të tilla që nga refuzimi i dhënies së dosje(eve)s ose dokument(eve)it i sheh të përshtatshme.

4.9 Zyrtarët e institucionit të Avokatit të Popullit në çdo kohë mund të hyjnë dhe të inspektojnë çdo vend ku personat janë të privuar lirie dhe mund të jenë të pranishëm në mbledhje apo në seanca dëgjimore ku përfshihen personat e tillë. Zyrtarët e institucionit të Avokatit të Popullit mund të mbajnë edhe mbledhje private me personat e tillë. Ndërmjet institucionit të Avokatit të Popullit dhe autoriteteve kompetente përkatëse zhvillohen procedura të veçanta për të lehtësuar ushtrimin e pushtetit sipas këtij paragrafi, veçanërisht qasja e menjëhershme dhe pa paralajmërim i zyrtarëve të institucionit të Avokatit të Popullit në çdo vend ku personat janë të privuar lirie.

4.10 Gajtë ose pas ndonjë hetimi, Institucioni i Avokatit të Popullit mund t'i bëjë rekomandime autoriteteve përkatëse rreth masave dhe procedurave të përshtatshme që duhet miratuar, duke përfshirë edhe masat e përkohshme nëse kjo është e nevojshme.

4.11 Pas përfundimit të hetimeve, Institucioni i Avokatit të Popullit mund t'u rekomandojë autoriteteve kompetente që të ngrisin procedurë administrative, civile apo penale kundër cilitdo personi.

4.12 Nëse, pas rekomandimeve të bëra nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, autoritetet përkatëse nuk i ndërmarrin masat ose procedurat e duhura me kohë, apo nuk i ofrojnë arsyetim të pranueshëm Institucionit të Avokatit të Popullit pse është vepruar në atë mënyrë, Avokati i Popullit mund ta vë në dijeni Kuvendin e Kosovës dhe Qeverinë për këtë çështje dhe mund të dalë me një deklaratë publike për këtë çështje.

4.13 Institucioni i Avokatit të Popullit i publikon rekomandimet e tij, përveç rasteve kur ai konsideron se faktet dhe situatat janë konfidenciale apo sekrete, apo në rastet kur ankuesi ose pala e dëmtuar nëse hetimi është nisur sipas detyrës zyrtare kërkon

shprehimisht që identiteti i tij a i saj dhe rrethanat e që kanë të bëjnë me rastin të mos zbulohen.

4.14 Nuk mund të ketë ankesë kundër çfarëdo veprimi apo vendimi të institucionit të Avokatit të Popullit.

4.15. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij sipas kësaj Rregulloreje, Institucioni i Avokatit të Popullit mund të kërkojë bashkëpunim nga UNMIK-u, gjë që nuk duhet pamundësuar pa arsye, duke e përfshirë sigurimin e informatave, dosjeve dhe dokumenteve përkatëse të cilat e ndihmojnë rishikimin e rastit të cilin është duke e shqyrtuar Institucioni i Avokatit të Popullit.

Neni 5

Përbërja e institucionit të Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit përbëhet nga avokati i popullit, zëvendësi kryesor i avokatit të popullit, tre (3) zëvendësavokatëve të popullit dhe nga një personel i aftë e profesionist. Avokati i popullit i përcakton përgjegjësitë e zëvendësit kryesor dhe të zëvendësve të tjerë të tij.

Neni 6

Avokati i popullit, zëvendësi kryesor dhe zëvendësit

6.1 Avokati i popullit dhe zëvendësi kryesor i tij duhet të jenë personalitete të njohura me karakter të lartë moral, të paanshëm dhe me integritet, që janë të dëshmuar e të përkushtuar për të drejtat e njeriut dhe të cilët janë banorë të përhershëm të Kosovës.

6.2 Avokatin e popullit dhe zëvendësin kryesor të tij i emëron Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente të votimit me përkrahjen e shumicës së deputetëve të Kuvendit të Kosovës pas njoftimit publik të bërë nga Kryesia e Kuvendit me të cilën i bëhet thirrje organizatave dhe institucioneve të cilat merren me mbikëqyrjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore që të bëjnë propozime brenda një periudhe jo më të shkurtë se dyzet (40) ditë.

6.3 Mandati i avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij është katër (4) vjet. Emërimi mund të përtërihet edhe për një mandat tjetër.

6.4 Tre (3) zëvendësit e avokatit të popullit duhet të jenë personalitete me karakter të lartë moral, të paanshëm dhe me integritet, që janë të përkushtuar e të dëshmuar për të drejtat e njeriut dhe të cilët janë banorë të përhershëm të Kosovës

6.5 Tre (3) zëvendësit e avokatit të popullit i emëron Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente të votimit me përkrahjen e shumicës së deputetëve të Kuvendit të Kosovës në bazë të rekomandimeve të paraqitura nga avokati i popullit pas njoftimit publik të bërë nga Kryesia e Kuvendit me të cilën i bëhet thirrje organizatave dhe institucioneve të cilat merren me mbikëqyrjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të bërë propozime brenda një periudhe jo më të shkurtë se dyzet (40) ditë.

6.6 Mandati i tre (3) zëvendësavokatëve të popullit është tri (3) vjet. Emërimi mund të përtërihet edhe për një mandat tjetër.

6.7 Në kuadër të personave të emëruar në postet e avokatit të popullit, zëvendësit kryesorë dhe tre (3) zëvendësve duhet të përfshet së paku një (1) pjesëtar i bashkësisë së shqiptarëve të Kosovës, së paku një (1) prej bashkësisë së serbëve të Kosovës dhe së paku një (1) person prej bashkësive të tjera joshumicë që ka të drejtë përfaqësimi në Kuvendin e Kosovës. Personat e emëruar shërbejnë në cilësinë e tyre individuale dhe bashkarisht e përfaqësojnë shumëllojshmërinë etnike të shoqërisë kosovare.

6.8 Në kuadër të personave të emëruar në postet e avokatit të popullit, zëvendësit kryesor dhe tre (3) zëvendësve duhet të përfshet së paku një (1) femër.

6.9 Para shpalljes së konkurseve publike në pajtim me paragrafët 2 dhe 5 të këtij neni nga Kryesia e Kuvendit, me çka kërkohet bërja e propozimeve për pozitën e avokatit të popullit, zëvendësit kryesor dhe zëvendësve të tjerë, Kuvendi i Kosovës në përputhje me rregullat e veta i miraton procedurat formale të cilat duhet të jenë të hapura dhe transparente. Këto procedura duhet të marrin parasysh në mënyrë të posaçme kriteret e përcaktuara në paragrafin 7 të këtij neni për përfaqësimin e bashkësive dhe në paragrafin 8 të këtij neni lidhur me barazinë gjinore.

6.10 Nëse interesimi përkitazi me konkurset publike në pajtim me paragrafët 2 dhe 5 të këtij neni nuk ia mundëson avokatit të popullit, zëvendësit kryesor dhe zëvendësve të tjerë që t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara në paragrafin 7 të këtij neni për përfaqësimin e bashkësive dhe në paragrafin 8 të këtij neni lidhur me barazinë gjinore, Kryesia e Kuvendit mund t'i rekomandojë Kuvendit që një ose më shumë poste të zëvendësve të avokatit të popullit të mbahen të paplotësuara dhe të kërkohet bërja e propozimeve të tjera derisa të plotësohen kriteret e përcaktuar në paragrafët 7 dhe 8.

6.11 Mandati i Avokatit të Popullit, zëvendësit kryesor dhe tre (3) zëvendësve të tjerë përfundon me rastin e skadimit të tij, të dorëheqjes, vdekjes apo largimit prej detyrës nga Kuvendi i Kosovës, siç është paraparë në nenin 8 të kësaj Rregulloreje. Kryesia e Kuvendit e shpall konkursin publik për të plotësuar pozitën e lirë të avokatit të popullit,

zëvendësit kryesor ose zëvendës(ve)it tjetër brenda katërbëdhjetë (14) ditëve prej përfundimit të mandatit përkatës.

6.12. Pas emërimit, avokati i popullit, zëvendësi kryesor dhe zëvendësi(t) tjerë e japin betimin solemn para Kuvendit të Kosovës. Teksti i betimit është si në vijim: “Unë betohem dhe premtoj solemnisht se do t’i kryej me besnikëri detyrat dhe funksionet që më janë besuar me ligj për t’i mbrojtur dhe avancuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në Kosovë, se do t’i kryej detyrat e mija në tërësi e në mënyrë të paanshme dhe se nuk do të kërkoj apo të marr udhëzime prej ndonjë burimi të jashtëm”.

Neni 7

Personeli

Personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit përzgjedhet nga radhët e banorëve të përhershëm të Kosovës që kanë standarde të larta të aftësisë, efikasitetit dhe integritetit. Personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit është pjesë e shërbimit civil të Kosovës, gjë që nuk e cenon ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre si personel i Insitucionit të Avokatit të Popullit. Asnjë pjesëtar i personelit të Institucionit të Avokatit të Popullit nuk duhet të merr pjesë në shqyrtimin e ndonjë rasti në të cilin ai ose ajo apo ndonjë pjesëtar i familjes së tij o të saj ka ndonjë interes të natyrës personale apo financiare e i cili mund ta bie në pikëpyetje aftësinë e Institucionit të Avokatit të Popullit për të vepruar në mënyrë të paanshme.

Neni 8

Papërshatshmëria dhe largimi nga funksioni

8.1 Postet e avokatit të popullit, zëvendësit kryesor dhe zëvendësve të tjerë dhe të personelit të Insitucionit të Avokatit të Popullit janë të papajtueshme me ushtrimin ose mbajtjen e çfarëdo aktiviteti politik, publik apo profesional privat.

8.2 Me kërkesë të çdo deputeti të Kuvendit, të nënshkruar edhe nga pesë deputetë të tjerë, Kuvendi i Kosovës mund ta largojë ose përkohësisht ta suspendojë nga detyra avokatin e popullit, zëvendësin kryesor dhe zëvendës(in)it tjerë me anë të votimit me mbështetjen e dy të tretave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, nëse konsideron se një apo më shumë nga arsyet e poshtëshënuara janë vërtetuar përkitazi me avokatin e popullit, zëvendësin kryesor apo zëvendës(in)at tjerë:

(a) paaftësia fizike apo mentale që ndikon në mundësinë e tij apo të saj për të kryer funksionet e tij a të saj,

(b) dënimi i plotfuqishëm në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare për veprë penale të dënueshme me burgim,

(c) moskryerja e funksioneve zyrtare të tij apo të saj sipas vendimit të bazuar në vlerësimin e Kuvendit të Kosovës ose

(ç) për shkak të sjelljes së tij personale apo diç tjetër, që është në kundërshtim me ushtrimin e funksioneve të tij apo të saj.

8.3 Avokati i Popullit mund të kërkojë që Kuvendi i Kosovës të largojë ose përkohësisht të suspendojë nga detyra një apo me shumë zëvendësa të avokatit të popullit për shkak të një apo më shumë arsyeve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni.

8.4 Kuvendi i Kosovës, në përputhje me rregullat e veta i miraton procedurat formale, të cilat janë të hapura dhe transparente, me çka e përcakton procedurën me anë të së cilës Kuvendi i Kosovës:

(a) E largon ose përkohësisht e suspendon nga detyra avokatin e popullit, zëvendësin kryesor ose ndonjë zëvendës tjetër në pajtim me paragrafin 2 të kësaj Rregulloreje,

(b) E largon ose përkohësisht e suspendon nga detyra zëvendësin e avokatit të popullit në pajtim me paragrafin 3 të kësaj Rregulloreje,

(c) E kthen në detyrë avokatin e popullit, zëvendësin kryesor ose ndonjë zëvendës tjetër pas periudhës së suspendimit të përkohshëm në pajtim me paragrafët 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje

Neni 9

Rregullorja e punës

Institucioni i Avokatit të Popullit e miraton rregulloren e punës së tij.

Neni 10

Fshehtësia

Institucioni i Avokatit të Popullit dhe personeli i tij duhet të ruajë fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të dhënave që i merr, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurisë së ankuesve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve.

Neni 11
Bashkëpunimi

11.1 Të gjithë personat dhe subjektet nën juridiksionin e Institucionit të Avokatit të Popullit kanë obligim t'i ofrojnë Institucionit të Avokatit të Popullit tërë ndihmën e nevojshme e cila kërkohet në përputhje me këtë Rregullore.

11.2 Duke vepruar në përputhje me Kornizën Kushtetuese, Institucioni i Avokatit të Popullit mund të bashkëpunojë me institucionet tjera të Avokatit të Popullit dhe me organizata e institucione të tjera ndërkombëtare që merren me të drejtat e njeriut dhe monitorimin, mbrojtjen e avancimin e tyre.

Neni 12
Privilegjet dhe imuniteti

12.1 Avokati i popullit, zëvendësi kryesor i avokatit të popullit, zëvendësi a zëvendësavokatët e popullit dhe punonjësit e Institucionit të Avokatit të Popullit gëzojnë imunitet nga procedurat ligjore lidhur me fjalët e thëna apo të shkruara dhe veprat e kryera nga ata në cilësinë e tyre zyrtare. Imuniteti i tillë do të vazhdojë edhe pas përfundimit të marrëdhënies së tyre të punës me Institucionin e Avokatit të Popullit.

12.2 Zyrat e Institucionit të Avokatit të Popullit janë të pacenueshme. Arkivat, lëndët, komunikimet, prona, fondet dhe pasuritë e Institucionit të Avokatit të Popullit, kudo që janë apo nga kushdo që mbahen, janë të pacenueshme dhe gëzojnë imunitet nga kontrolli, nga marrja, nga kërkimi zyrtar i tyre, nga konfiskimi, nga shpronësimi apo nga çfarëdo ndërhyrje tjetër qoftë përmes veprimit përmbarues, administrativ, gjyqësor apo legjislativ.

12.3 Paragrafi 2 i këtij neni nuk e pamundëson:

(a) Kryerjen e kontrollit financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë të shpallura përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/17 të datës 12 maj 2003 dhe

(b) Kryerjen e funksioneve të Bordit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës përkitazi me Institucionin e Avokatit të Popullit në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 të datës 22 dhjetor 2001 për Shërbimin Civil të Kosovës.

12.4 Paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk paragjykojnë autorizimet e UNMIK-ut sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Neni 13
Heqja e privilegjeve dhe e imunitetit

Në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, Kuvendi i Kosovës në konsultim me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm mund t'i heqë privilegjet dhe imunitetin të parapara në nenin 12 të kësaj Rregulloreje përmes votimit të dy të tretave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Neni 14
Zyrat dhe objektet e Institucionit të Avokatit të Popullit

14.1 Selia e institucionit të Avokatit të Popullit është në Prishtinë. Sipas nevojës, ky institucion mund të hapë zyra të tjera brenda teritorit të Kosovës.

14.2 Institucioni i Avokatit të Popullit do të ketë objekte të duhura për punë dhe pajisje të tjera në mënyrë që të mundësohet kryerja efektive e funksioneve dhe e përgjegjësiive të tij.

Neni 15
Gjuhët e punës

Gjuhët e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe.

Neni 16
Raportet

16.1 Institucioni i Avokatit të Popullit harton raportin vjetor dhe ia dorëzon Kuvendit të Kosovës, si dhe i bën publike rezultatet e raportit.

16.2 Institucioni i Avokatit të Popullit mund të nxjerrë raport të posaçëm dhe ia dorëzon Kuvendit të Kosovës nëse kjo mundësohet nga rrethanat. Raportet e tilla të posaçme do të bëhen publike.

Neni 17
Financimi

17.1 Institucionit të Avokatit të Popullit do t'i ndahen fonde të mjaftueshme nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për t'i mundësuar kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësiive të tij në mënyrë të plotë dhe të pavarur. Autoritetet publike nuk do ta shfrytëzojnë procesin buxhetor për ndarjen e fondeve nga Buxheti i Konsoliduar i

Kosovës në mënyrën që do të ndërhynte në pavarësinë e Institucionit të Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit mund t'ia tërheqë vëmendjen Kuvendit të Kosovës lidhur me propozimet buxhetore të Qeverisë që mund të rrezikojnë aftësinë e Institucionit të Avokatit të Popullit për të kryer funksionet e tij në mënyrë të plotë dhe të pavarur.

17.2 Institucioni i Avokatit të Popullit mund të pranojë donacione shtesë nga donatorët ndërkombëtarë, që do të regjistrohen në pasqyrën financiare vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit brenda Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Resurset e donatorëve që janë dhënë në dispozicion dhe që janë pranuar nuk ndikojnë në pavarësinë e Institucionit të Avokatit të Popullit apo në të drejtat e tij në fonde prej Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

Neni 18

Nivelet e pagës së avokatit të popullit, të zëvendësit kryesor të avokatit të popullit dhe të zëvendësit të avokatit të popullit

18.1 Niveli i pagës së avokatit të popullit është i barabartë me atë të kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

18.2 Niveli i pagës së zëvendësit kryesor të avokatit të popullit dhe të zëvendësavokatëve të popullit është i barabartë me atë të gjyqtarit në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Neni 19

Dispozitat kalimtare dhe shfuqizimi

19.1 Institucioni i Avokatit të Popullit themelohet pas emërimit të avokatit të popullit dhe të zëvendësit kryesor të avokatit të popullit sipas kësaj Rregulloreje.

19.2 Zëvendësit e avokatit të popullit që gjenden në këto poste pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, mbesin në të njëjtin post dhe i ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/38 të datës 30 qershor 2000 për themelimin e Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë deri në themelimin e Institucionit të Avokatit të Popullit.

19.3 Personi që është zëvendës i avokatit të popullit në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, mund të emërohet si avokat i popullit a si zëvendës kryesor i avokatit të popullit sipas nenit 6.2 apo si zëvendësavokat i popullit sipas nenit 6.5 dhe emërimi i tillë mund të ripërtëritet edhe për një mandat tjetër në pajtim me nenin 6.3 apo me nenin 6.6.

19.4 Pas emërimit të avokatit të popullit dhe të zëvendësit kryesor të avokatit të popullit, çdo zëvendës i avokatit të popullit që mbetet në post në pajtim me paragrafin 2

të këtij neni, e i cili nuk është emëruar avokat i popullit apo zëvendës i avokatit të popullit, përkohësisht do të shërbejë si ushtrues i detyrës së avokatit të popullit dhe, si i tillë, e ushtron pushtetin dhe përgjegjësitë në përputhje me këtë Rregullore deri në emërimin e tre zëvendësve të avokatit të popullit në pajtim me nenin 6.5.

19.5 Rastet e shkeljeve të pohuara të standardeve të të drejtave njerëzore nga institucionet e Kosovës që janë themeluar pak përpara themelimit të Institucionit të Avokatit të Popullit, të cilat raste kanë qenë ende nën hetimin e Institucionit të Avokatit të Popullit të themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/38 apo nën hetimin e zëvendësve të avokatit të popullit në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, pas themelimit të Institucionit të Avokatit të Popullit do të mbeten përgjegjësi e Institucionit të Avokatit të Popullit të themeluar sipas kësaj Rregulloreje.

19.6 Përveç kur parashihet sipas paragrafit 2 të këtij neni, Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2000/38 e datës 30 qershor 2000 mbi themelimin e Institucionit të Avokatit të Popullit shfuqizohet në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 20
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 21
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore e shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në përputhje me të.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 16 shkurt 2006.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm